



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2022:183322

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06018796

CAP.nr.11/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin Adnan Konushevci, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit B.B, nga Komuna e Gj..., Rruga “Mulla Idrizi”, Kompleksi “Plisi”, Kati -II-, kundër debitorit Restorant “Pizzeria D&D” Sh.P.K, me NUI:XXXXX, me adresë në Komunën e V..., Rruga “Muhamet Muharremi”, p.n., me pronarë F.A, lidhur me çështjen përmbartimore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës të debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, PPP.nr.22/2022 i datës 14.11.2022, me datë 05.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET e bazuar ankesa e debitorit Restorant “Pizzeria D&D” Sh.P.K, me NUI:XXXX, me adresë në Komunën e Vitisë, Rruga “Muhamet Muharremi”, p.n., me pronarë F.A, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, PPP.nr.22/2022 i datës 14.11.2022, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: PRANOHET i bazuar prapësimi i debitorit Restorant “Pizzeria D&D” Sh.P.K, me NUI:811511999, me adresë në Komunën e Vitisë, Rruga “Muhamet Muharremi”, p.n., me pronarë F.A, SHFUQIZOHET (vihet jashtë fuqie), urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.560/2022, i datës 19.08.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Pivat K.M, që vepron në territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbartimore, ndërsa propozimi për përmbartimi i kreditorit B.B, nga Komuna e Gjilanit, Rruga “Mulla Idrizi”, Kompleksi “Plisi”, Kati -II-., REFUZOHET I PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.22/2022 i datës 14.11.2022, ka vendosur si në vijim: *“I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit, Restorant Pizzeria D&D sh.p.k, me pronar F.A nga V..., sipas Urdhërit Përmbartimor P.nr.560/2022, i datës*

*19.08.2022, të dhënë nga Përmbauesi Privat K.M, që vepron në territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, për lejimin e përmbaimit, lidhur me pagesat e qerasë së/debitorit për detyrimin, e cila është evidentuar në shumën prej 1,500 €. Dhe -Bllokimin e gjitha llogarive nëpër bankat komerciale në Kosovë në emër të debitorit. II. Urdhri i lejuar P.nr.560/2022, i dt.19.08.2022, i dhënë nga Përmbauesi Privat K.M nga Gjilani mbetet në fuqi”.*

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, debitori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbaimore dhe kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që ankesën e debitorit ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ta shfuqizojë në tërësi aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë PPP.nr.22/2022 i datës 14.11.2022, si dhe ta shfuqizojë në tërësi urdhrin për lejimin e përmbaimit P.nr.560/2022, i datës 19.08.2022, i lejuar nga Përmbauesi Privat K.M, që vepron në territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i goditur me ankesë i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa të debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 19.08.2022, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbaimit në bazë të dokumentit Akt noterial, Kontratë për Qiranë e Lokalit Afarist, Nr.1178/2022 dhe Ref.276/2022 të datës 18.02.2022, e lidhur në praninë e Noterit F.H në Komunën e Gjilanit, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbaimit.

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të datës 19.08.2022, me Urdhër Përmbaimit, nën shenjë P.nr.560/2022, e ka lejuar përmbaimit duke vlerësuar se akti noterial mbi të cilën është propozuar lejimi i përmbaimit, i plotëson kushtet si dokument përmbaimit.

Kundër Urdhrit Përmbaues mbi lejimin e përmbaimit debitorit ka paraqitur prapësim me datën 29.08.2022, me propozim që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri për përmbaimit. Ndërsa kreditori me datë 05.09.2022, ka ushtruar përgjigje në prapësim dhe ka kërkuar që të refuzohet prapësimi si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri i lejuar përmbaimit.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse të paraqitura në prapësim si dhe përgjigjes në prapësim, ka ardhur në përfundim së prapësimi është i pa bazuar, pasi që Dokumenti përmbarues - Akt noterial, Kontratë për Qiranë e Lokalit Afarist, Nr.1178/2022 dhe Ref.276/2022 i datës 18.02.2022, e lidhur në praninë e Noterit F.H në Komunën e Gjilanit, ndërmjet debitorit dhe kreditorit, mbi bazën e të cilit është lëshuar Urdhri për Përmbarim, i plotëson të gjitha kushtet ligjore për t'u përmbaruar. Rrjedhimisht, ky dokument paraqet një dokument të përmbarueshëm dhe të ekzekutueshëm sipas dispozitave të lartpërmendura të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata duke iu referuar nenit 73 të LPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ju ka referuar neneve 5, 13, 17, 22, 38, 71 73 par. 3 dhe 78 par. 2, LPP-së.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar nenin 22 paragrafi 1 nën paragrafi 3, neni 69 paragraf 4, 71 dhe 73 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë atë se çka konsiderohet dokument i përshtatshëm për përmbarim dhe mbi cilën bazë mund të iniciohet procedura e përmbarimit.

Me nenin 22 paragrafi 1, nën paragraf 3, të LPP-së, përcaktohet se: "Dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë", me këtë dispozitë është përcaktuar se çka konsiderohet dokument përmbarimor, që rezulton se ky dokument- akti noterial është i përmbarueshëm por duhet të jetë i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterin, mirëpo i njëjti dokument përveç që duhet të jetë i përmbarueshëm duhet të jetë edhe i përshtatshëm për përmbarim për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të LPP-së, të cilat kërkesa që rezultojnë nga kjo dispozitë ligjore e bëjnë dokumentin të përshtatshëm përmbarim. Sepse me nenin të 27 të LPP-së, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se: "*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim*

*në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”.*

Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kushtet në fjalë siç u theksuan më lart, që dokumenti duhet të ketë titull përbarimor dhe duhet të jetë i përshtatshëm për përbarim, duhet të plotësohen në mënyrë komulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përbarimor të papërshtatshëm për përbarim, siç është në këtë rast me dokumentin – aktin noterial mbi të cilin është lejuar përbarimi sepse dokumentin në fjalë, ka titull përbarimor, por është i papërshtatshëm për përbarim, pasi që dokumentit i mungon shuma e mjeteve për ekzekutim, koha e përmbushjes së detyrimit. Pas i që me shikimin e shkresave të lëndës konstatohet se në këtë rast gjykata e ka lejuar përbarimin dhe e ka cilësuar si titull përbarues aktin noterial lëndor, mirëpo Gjykata e Apelit vlerëson se akti noterial si i tillë mund të konsiderohet titull përbarues, por nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për përbarim, ashtu siç u vlerësua më lart për arsye se nuk e përmban shumën e detyrimit, nuk përmban periudhën kohore dhe nuk përmban afatin brenda të cilës duhet të përmbushet detyrimi, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore të cekura me lartë.

Titulli përbarues është ai mbi bazën e të cilit inicohet procedura e përbarimit dhe realizohet kërkesa e përmbajtur në të. Gjykata e Apelit vlerëson se në rrethana të tilla nuk ka pasur kushte ligjore të inicohet procedura e përbarimit dhe të lejohet përbarimi nga gjykata e shkallës së parë, kjo pasi që akti noterial në bazë të cilit është iniciuar procedura përbarimore nuk është i përshtatshëm për përbarim, ashtu siç është përcaktuar, me nenin 27 të LPP-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se Dokumenti mbi të cilin është lejuar përbarimi në këtë rast, është nxjerr në përputhje me Ligjin për Noterinë, si ligj i veçantë konkretisht neni 43.1 dhe 43.6 të Ligjit për Noterinë. Me nenin 43.1 përcaktohet se: *“Dokumenti noterial është dokument përbarimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përbarimi i detyrueshëm.”*, ndërsa me nenin 43.6 përcaktohet se: *“Në rastet kur dokumenti noterial është dokument përbarimor sipas këtij neni, noteri me kërkesën e palës, vet e vënë në dokument vërtetimin për përbarueshmërinë”*. Në këtë rast dokumentit – aktit noterial, mbi të cilin është lejuar përbarimi, përveç se nuk i plotëson kushtet ligjore që rezultojnë nga neni 27 i LPP-së, i njëjti nuk është i pajisur më vulën e plotfuqishmërisë për përbarueshmëri, siç kërkohet më dispozitën e lartcekur ligjore.

Duke i pasur parasysh të cekurat më lartë, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën material në këtë rast sepse akti noteriale përveç që nuk i plotëson kushtet ligjore të vlerësuara si më lart i njëjti, nuk është bërë i përmbareshëm as sipas nenit 26 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbareshme përcakton se: *“1. Dokumenti i noterizuar është i përmbareshëm nëse është bërë i përmbareshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbareshmërin e atij dokumenti.”*

Për më tepër kreditori nëse edhe mëtej mbetet pran pretendimeve të tij, të drejtën e tij të pretenduar mundet që ta realizojë eventualisht në procedurë tjetër, mirëpo jo në këtë procedurë, për arsye se në këtë procedurë vlerësohet vetëm dokumenti mbi të cilin lejohet përmbareshimi ashtu siç u vlerësua më lart.

Gjykata e Apelit vlerësoi provat në shkresat e lëndës dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i atakuar të ndryshohet, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbareshimit dhe të refuzohet propozimi për përmbareshim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata e Apelit vendosi duke u mbështetur në nenin 450 dhe 463 paragraf 1 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, duke marr për bazë suksesin e palëve në procedurë dhe faktin se pala debitorë shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar-specifikuar.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr. 11/23 me datë 05.08.2024

Gjyqtari  
Adnan Konushevci